



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0308

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Besa Security Sh.P.K.”, kundër Vendimin për dhënie të kontratës të Kuvendi Komunal – Rahovecë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës” me nr. të Prokurimit: "623-24-1213-2-2-1", me 13/06/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Besa Security Sh.P.K.” me nr. 2024/0308 , e datës 08/04/2024, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal – Rahovecë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "623-24-1213-2-2-1", mbetet në fuqi vendimi i AK-së.
2. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Besa Security Sh.P.K.”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.02.2024, Kuvendi Komunal – Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "623-24-1213-2-2-1". Ndërsa me datën 22.03.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 70.000 euro.

Me 22.03.2024, OE “Besa Security Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 27.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.04.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Besa Security Sh.P.K.” me nr. 308/24 lidhur me aktivitetin “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "623-24-1213-2-2-

1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Besa Security Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): “Ju nuk keni dorëzuar Autorizimin për nisjen fillestare të veprimtarisë të noterizuar sipas kërkesës së AK-së.

Kërkesa ka qenë për noterizim vetëm të licencës, e jo të autorizimit. Citim nga dosja e tenderit Dëshmia 3. Kopja e noterizuar e Licencës dhe Autorizimi për nisjen fillestare të veprimtarisë (valide). Andaj, pretendimi i AK nuk qëndron, është diskriminues dhe ka për qëllim eliminimin e kompanisë tonë nga aktiviteti, pasi sipas Nenit 23 Autorizimi për fillimin e veprimtarisë të ligjit për Shërbime Private të Sigurisë - Kompania private e sigurimit nuk do të fillojë ushtrimin e veprimtarisë para se organi kompetent ta ketë dhënë autorizimin për nisjen fillestare të veprimtarisë. Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.

Pretendimi i dytë (II): Ju nuk keni dorëzuar deklaratën sipas kërkesës së AK-së. Mungon deklarata si dëshmi e kërkuar si dhe po ashtu mungon edhe njoftimi i MPB i lëshuar për pajisje sipas kërkesës së AK-së. Tek dokumenti i emërtuar 6. Raporti mbi uniformat dhe pajisjet e rojeve” fjala e parë e këtij dokumenti është deklarata e kërkuar. Pastaj vijon raporti i uniformave, vijon vendimi i aprovimit të uniformave nga MPB. Sa i përket vendimit pajisjeve, kjo automatikisht shkon me Licencën për Shërbime Themelore dhe nuk ka vendim të veçantë. Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.

Pretendimi i tretë (III) : Autorizimi i kësaj licence me nr. 195 i datës 09.02.2024 nuk është valide, ky autorizim ka skaduar me datën 10.02.2024 dhe nuk është sipas kërkesës së AK-së. Të nderuar, autorizimi për fillim të veprimtarisë merret në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe zgjat po aq sa zgjat edhe kontrata. Në këtë rast, për tubime publike, përveç se është absurde të kërkohet një gjë e tillë – nuk kemi menduar që të krijojmë event të veçanta për të marrë këtë autorizim që të jetë valid në periudhën e njëjtë të dorëzimit të tenderit. Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.

Pretendimi i katërt (IV) : Tek lista e përshkrimit të çmimit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga tenderuesit që të japin çmimin për 1 muaj, çmimi juaj në shumë 69592,80 € e tejkalon shumëfish vlerën e parashikuar të kontratës, ku çmimi juaj do të del në total 69,592.80 € x 24 muaj = 1,670,227,20 € kurse vlera e parashikuar për këtë kontratë është 70000,00 € duke llogaritur +/- 30% të devijimit të lejuar. Fillimisht, nëse shikojmë paramasën në detaje, është paramasë që as AK nuk e ka idenë se çfarë ka vendosur në të. Është vendosur njësi = muaj, pastaj sasia e orëve = 1, është kërkuar çmimi për njësi dhe çmimi total. Tek çmimi për njësi ne kemi vendosur çmimin për një muaj prej 2,899,70 €, që vërteton edhe tek dokumenti i analizës financiare i dorëzuar me tender, me emërtim: “22. Deklaratë mbi pagën dhe analiza financiare.pdf”.

Totali i ofertës për 24 muaj është 69,592,80€, që është brenda kornizës së vlerës së kontratës prej 70,000 € duke përfshirë devijimin e lejuar +/-30% siç e keni cekur.

Tek kjo e fundit AK vazhdon të bëjë shkelje edhe më shumë, pasi që kemi cilësuar si të suksesshëm një ofertë e cila e tejkalon edhe 30% e vlerës së parashikuar të kontratës, pra $4,555€ \times 24 \text{ muaj} = 109,320€$ ndërsa , $70,000+30\% = 91,000 €$, pra del për 39,320 € jashtë buxhetit, si dhe 18,320 jashtë 30% të lejuar.

Përveç shkeljes se nenit 7 – Barazia ne Trajtim / Jo Diskriminimi, këtu kemi të bëjmë me shkelje të Nenit bazë të LPP, neni 1 Qëllimi, e po ashtu neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.

Bashkëngjitur në vijim gjeni Analizën financiare dhe përshkrimin e çmimit e dorëzuar nga ne.

Andaj kumtojmë që në këtë Aktivitet të Prokurimit të behet rivlerësimi i ofertave dhe të shpallet fitues Besa Security ShPK.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Pro & Co Group Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Nenet 27, 56.3, 59.4, 60.1.1, 62, 72 të LPP-së si dhe neni 8, 9, 11 i Rregullores nr. 001/2022, të KRPP-së. Prandaj, konzerciumi jone “Pro & Co Group” ShPK & Floring ShPK, bazuar në atë që u tha si me larte kërkojmë nga OSHP që të nxjerrë: Vendim -Të aprovohet kërkesa jonë në tërësi si e bazuar Të kthehet lënda në rivlerësim dhe ri vendosje tek AK - Ministria e Arsimit dhe të aplikohen drejt dispozitat ligjore dhe të anulohet vendimi për Anulim të aktivitetit të prokurimit.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik BESA SECURITY SH.P.K., me qendër në Prishtinë, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Megjithatë, pas shqyrtimit të pretendimeve të tyre, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se kërkesa e tyre nuk ka bazë ligjore. Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë se ka një interes të drejtpërdrejtë për procedurat e prokurimit, siç kërkohet nga ligji. Po ashtu, ata nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm dhe dokumentet që kanë paraqitur kanë qenë jovalide për shkak të skadimit të tyre. Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka vënë në dukje se kërkesat e tyre për noterizim janë në përputhje me specifikat e njoftimeve të tenderit dhe dosjes së tenderit. Përveç kësaj, ata nuk kanë plotësuar të gjitha kërkesat dhe nuk kanë dëshmuar për përfshirjen e Autorizimit të skaduar. Gjithashtu, ata kanë tejkaluar limitet e çmimeve të parashikuara në tender, duke shkelur kushtet e specifikuara në rregulloren e prokurimit publik. Autoriteti Kontraktues i kërkon Operatorit Ekonomik të respektojë vendimet e tyre dhe të mos bëjë akuza pa bazë. Pas anashkalimit të kërkesës së tyre për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues do të marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin. Andaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ana juaj hedhet si e pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 12.04.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 308/2024, ndërsa me datë 03.05.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/308 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar vetem për pretendimin ankimor nr 1 dhe 4, ndërsa rekomandoj që të mbetet ne fuqi vendimi i AK-së Komuna Rahovecit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, OE nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “BESA SECURITY SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/308 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) : Në lidhje me këtë pretendim ankimor të OE ankues për kërkesën që ka të bëjë me dëshminë nr 3 Kopje e noterizuar e Licencës dhe Autorizimi për nisjen fillestare të veprimtarisë (valide) eksperti sqaron se AK Komuna e Rahovecit ka vepruar në kundërshtim me nenin 52.3 dhe 56.3 të LPP-së, pasi që sipas kërkesës së DT fjala DHE nuk ndërlidhët për kërkesën që Autorizimi për Nisjen Fillestare të Veprimtarisë të jetë i noterizuar, pasi që as kund nuk thuhet që ky dokument të jetë i noterizuar, por fjala DHE në këtë rast nënkupton dhe dokumentin tjetër sipas kërkesës së DT që është Autorizimi për Njësinë Fillestare të Veprimtarisë (valide), andaj pretendim ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II) : Pas analizimit të dokumenteve të ofruara në e-prokurim në lidhje me pretendimin ankimor eksperti sqaron, se në lidhje me këtë qështje OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e DT pasi që i njëjti nuk ka arritur të ofroj njoftimin e MPB-së në lidhje me pajisjet ashtu siç kërkohet me ligjin Nr 04/L-004 për shërbimet private të sigurisë, dhe Udhëzimit administrativ Nr. 09/2012, për blerjen, ruajtjen dhe përdorimin e pajisjeve, andaj pretendim ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Konstatimi i tretë (III) : Në lidhje me këtë pretendim ankimor eksperti sqaron se OE ankues është dashur që këtë kërkesë të AK të vendosur në DT ta sqarojë brenda afateve ligjore të përcaktuara në DT gjatë fazës së tenderimit, pasi që edhe vet OE ankues konstaton se ky autorizim merret në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe zgjat po aq sa zgjat kontrata, gjë që kjo dëshmon se ju si OE ankues nuk e keni plotësuar kërkesën e AK të vendosur në DT, për dallim nga ju si OE i rekomanduar për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit të njëjtën kërkesë të AK e ka plotësuar ashtu siç kërkohet në DT, andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Konstatimi i katërt (IV) : Në lidhje me këtë pretendim ankimor eksperti sqaron, se bazuar në DT tek Pjesa II. lista e çmimeve AK sipas kësaj liste nuk e ka definuar qartë se a e kërkon çmimin për muaj apo çmimin për orë, pasi që sipas kësaj liste njësi matëse është MUAJ dhe sasia është ORË dhe pastaj çmimin për njësi me TVSH. Duke u bazuar tek lista e çmimeve të ofruar nga OE ankues i njëjti e ka ofruar çmimin për njësi me TVSH pasi që njësi matëse në këtë rast është muaj dhe bazuar në RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK nenin 54.15

thuhet se kontratat e kësaj natyre (shërbime) lidhen me çmim për njësi dhe realizohen deri në vlerë të parashikuar, dhe në këtë rast OE ankues nuk e ka tejkaluar vlerën e paraparë për këtë kontrata marr për bazë edhe çmimin e ofruar te Pjesa 1 FORMUARI I TENDERIT, andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Besa Security Sh.P.K.” Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet nr.1 dhe nr.4 të operatorit ekonomik ankues “Besa Security Sh.P.K.” janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "623-24-1213-2-2-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Besa Security Sh.P.K.” dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit pa nevoj që të njëjtat të përsëriten edhe një herë nga ana e këtij Paneli. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues, i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, pa nevoj që të njëjtat të përsëriten edhe një herë. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorëve ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara dhe vendimi i AK duhet të mbetet në fuqi.

Andaj, Paneli shqyrtues duke u bazuar në rekomandimin e ekspertit shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduara për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të

jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojnë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojnë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - BESA SECURITY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: